

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E ENJTE 22 SHTATOR 2022

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

E nisa fjalën time në seancën e kaluar me një sens të lartë etik ndaj pushtetarëve që kemi këtu. Me siguri etika nuk është muzikë e dëgjuar dhe as notë që shkruhet për ata që nuk dëgjojnë dot thirrjet e nevojës, halleve dhe pamundësive të shqiptarëve. Sot në rendin e ditës kemi aderimin në konventën e organizatës ndërkombëtare “Për ndihmat detare në lundrim”. Këto çështjet e lundrimeve u duken shqiptarëve si përkundje ndaj halleve të tyre. Sot shqiptarët nuk kanë bukë në shtëpi, disa ironizojnë, por është reale, e llogarisin jo njëmijëlekëshin, por edhe njëqindlekëshin, sepse në këtë vend çdo gjë është e shtrenjtë.

Pavarësisht thirrjeve të opozitës dhe dëshirës për të bërë reforma dhe ndryshime, që vërtet mund t’i mbrojnë interesat e qytetarit, ju refuzoni të dëgjoni e të punoni në të mirë të popullit shqiptar. Kërkoni që të kaloni me procedurë të thjeshtë një projektligj, i cili është qartësisht abuzues dhe shkon ndesh me çdo princip themelor të tregut të lirë. Ju kërkoni me aq shumë ngulm ta mbani kokulur këtë popull, sa nuk ju mjaftoi ai palo bord me ata palo joprofesionistë që keni vendosur në atë farsë që e quani Bordi i Transparencës. A keni të ngopur?! Kjo është pyetje retorike, sepse për 9 vjet kemi parë se ju jo vetëm që nuk keni të ngopur, por, pa ua marrë edhe gjakun shqiptarëve, nuk do ta lëshoni këtë vend, të cilin e keni marrë peng.

Javës që kaloi zëvendëskryeministrja, njëkohësisht edhe ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, na tha se nuk kishte prova për fjalët që ajo thoshte në videoskandalet, të cilat kanë pushtuar rrjetet dhe, sipas saj, unë nuk duhej t’i flisja e t’i kërkoja llogari një gruaje. Unë i kam ndihmuar lëvizjet feministe, por luftoj e do të luftoj më shumë dhe së pari për të drejtat e njeriut. Meqë nuk na lejohet që t’u flasim grave, që janë në një pozitë me rëndësi, atëherë e

ftoj ministren, pa diskriminim gjinor, që të japë dorëheqjen, sepse është grua dhe duhet të ndiejë edhe pak më shumë, ndoshta, të lërë dikë, i cili arrin të kuptojë se, nëse je duke ia marrë shpirtin këtij populli, duhet të japësh llogari.

Kjo është një këshillë miqësore nga një qytetare drejt një qytetareje tjetër, zonja Balluku, sepse, kur t'ju bëjnë mish për top, siç ka ndodhur me ata që kanë bërë afera korruptive, të cilat mund të përfshijnë edhe Edi Ramën, edhe ju kaq do të jeni: thjesht një qytetare, e cila do të jetojë me familjen në këtë vend, që ju po e shkatërroi. Për sa më sipër, dua që të ndalem pak në faktet që ju kaq shumë i doni dhe m'i kërkuat me insistim herën e kaluar. Në tetor të vitit 2017 skandalet me tenderët ishin të mëdha. Besoj se e mbani mend Albkontrollin. Nuk ma merr mendja se i harroni aq kollaj tenderët e dhënë çuditërisht në vlerën 100%. Në buletin e prokurimit publik nr. 20, datë 22 maj 2017, në faqen 123 kemi procedurën nr. 691 me vlerë limit 10 461 111 lekë pa TVSH.

Çuditërisht, kemi vetëm një ofertues dhe çmimi i ofertës është 10 461 105 lekë pa TVSH. Këtu keni kursyer 6 lekë. Bravo ju qoftë! Në buletin e datës 8 maj 2017 në faqen 243 është procedimi i prokurimit nr. 726, me objekt "Ribërja e infrastrukturës mekanike dhe elektrike në malin e Krujës" me vlerë limit 30 milionë lekë pa TVSH. Edhe këtu fiton dikush me 99% të vlerës limit të vendosur nga ju. Në buletin nr. 17, datë 2 maj 2017, kemi kontratën me vlerën përfundimtare 6 562 812 lekë me TVSH. Këtu ndodh një habi tjetër, garuesi i vetëm e ka fituar me vlerën 110% nga vlera e ofruar. Në buletin nr. 17, në faqen 507, kemi objektin e prokurimit me vlerën limit 25 milionë lekë pa TVSH. Këtu tenderi është fituar me 100% të vlerës, vetëm 500 lekë të rinj keni kursyer.

Një tender tjetër në faqen 592 të buletinit të prokurimit publik ka vlerën limit 74 800 000 lekë pa TVSH dhe këtu keni kursyer 50 mijë lekë. Pra, nga 740 milionë ju keni kursyer 500 mijë lekë. Kalojmë në shtator të vitit 2020 me tenderin e famshëm të hekurudhës Tiranë-Durrës-Aeroport. Në këtë tender, nga pesë konkurrentë, dy nuk morën pjesë fare në tender, u tërhoqën; dy dhanë ofertën maksimale dhe një e fitoi tenderin të dhënë me fjalë nga ju. Në tetor 2020 vazhduat me tenderin e shokut tuaj, Mane, për portin e tij privat. Në janar 2021, kur vendi ishte në krizë nga përmytjet dhe kur shumë shqiptarëve po u shkatërrohej jeta, ju na përshëndesit

nga Nusreti dhe na porosisnit të ishim të fortë, pra meqë ne nuk kemi detyrën që t'ju mbajmë pishtarin se çfarë bëni me lekët tona.

Janë edhe sa e sa skandale me garat e punonjësve të Albpetrolit, apo menduat se ne do t'i harronim? Besoj se këto janë të largëta për kujtesën tuaj, ndaj po ju kujtoj ngjarjet e fundit. Në korrik 2022 keni shpenzuar 200 mijë euro për zyrën tuaj, pra 200 mijë euro e dilni na flisni për pishtarë me delirizmat tuaj. Skandaloze! Qershia mbi tortë, për të mbështetur edhe fjalën e Saliarit, është deklarata juaj se Zvicra i dënon qytetarët e saj nëse e vendosin kondicionerin mbi 19 gradë. Zonja Zëvendëskryeministre, gazeta "Faktoje" ka dërguar një email në Këshillin Federal të Zvicrës për t'u interesuar për këtë deklaratë dhe ata thonë se nuk ka mungesë të energjisë dhe nuk është vendosur asnjë lloj masë (dhe ju këtë deklaratë e bëni përpara nxënësve, duke përmendur fjalën "burg" me lehtësinë më të madhe).

Nuk e di se në cilin vend tjetër ndodh kjo gjë e paprecedentë. Duke qenë se Zvicra nuk po përballet me asnjë krizë, nuk ka në fuqi kufizime apo ndalime për përdorimin e energjisë, të cilat mund të shkelen. Kjo është fytyra faktike e qeverisjes suaj, pasqyra e fytyrës së pushtetit tuaj që kërkon të lahet me 30 gradë. Faleminderit!